L I G J
Nr. 8998, datë 30.1.2003

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.7, DATË 24.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8668, DATË 23.10.2000 "PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.7, datë 24.12.2002 i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit" sipas tekstit që vijon:

"Neni 14/1 i ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", ndryshon si vijon:

"Neni 14/1
Dispozitë kalimtare

Neni 3 i këtij ligji zbatohet pas datës 31.12.2005. Deri në këtë datë, shtetasit e moshës mbi 16 vjeç pajisjen me pasaportë të modelit ekzistues të vlefshme për 5 vjet, me të drejtë përtëritjeje deri në 3 vjet, ndërsa të miturit e moshës deri 16 vjeç pajisen pranë organit të policisë me leje kalimi të modelit ekzistues të vlefshme për 6 muaj dhe vetëm për një udhëtim."".

Shpallur me dekretin nr. 3688, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.